



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1213/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS Scardian J.S.C, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ajani & Adami Sh.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.197/2022 i datës 18.08.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Ajani & Adami Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.197/2022 i datës 18.08.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.197/2022 i datës 18.08.2023 në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Ajani & Adami Sh.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit për caktimin e Përmbarimit P.nr.2633/19 të datës 18.08.2023 të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Ajani & Adami Sh.P.K., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e debitorit, të shfuqizohet aktvendimi KPPP.nr.197/22 i datës 18.08.2023.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala kreditore, duke theksuar se debitorit me datë 26.03.2021, përmes transferit bankar nr. 00000842, në tërësi e ka përmbytur obligimin e tij ndaj kreditorit. Si rrjedhojë, organi përmbarimor Vais Law, me datë 30.03.2021, ka nxjerr urdhrin me të cilin e ka përfunduar procedurën përmbarimore.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KS Scardian J.S.C., me datën 24.09.2019 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor – Marrëveshja mbi pengun e datës 25.07.2017 në shumën e detyrimit në vlerën prej 1,000.000€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 30.04.2018 e deri në pagesën definitive si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përmbartimit.

Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.2633/19 të datës 25.09.2019, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 04.10.2019, ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin mbi caktimin e përmbartimit për shkak të ndryshimit të rrethanave tek debitori, të njëjtit i është vështirësuar gjendja ekonomike, andaj nuk ka pasur mundësi për përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorit, dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur pala kreditore, duke theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit për faktin se i njëjti nuk e ka kontestuar borxhin që ka ndaj kreditorit, e i cili borxh është siguruar me marrëveshjen e pengut, po ashtu debitori asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet si dhe nuk ka kërkuar asnjëherë që të lirohet nga përmbushja e detyrimit. Tutje, ka theksuar se kreditorit me debitorin kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore në mënyrë që t'i mundësohet të njëjtit pagesa e borxhit në emër të rimbursimit të garancionit të paguar, por përkundër kësaj, debitori nuk ka respektuar marrëveshjen. Andaj, i ka propozuar gjykatës, që prapësimin ta refuzoj, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhoma e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.197/22 i datës 18.08.2023, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.2633/19 të datës 25.09.2019 të lejuar nga përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor - Marrëveshja mbi pengun e datës 25.07.2017, shumën e detyrimit në vlerën prej 1,000.00€. Ka arsyetuar se për gjykatën Marrëveshja në fjalë në bazë të të cilës përmbartuesi privat ka zbatuar përmbartimin është dokument përmbartues dhe përbënë bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nge neni 22, pika 1.9 i LPP-së për të qenë të përmbartueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbartim. Prandaj,

gjkata e shkallës së parë si në rastin konkret, ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenin 22 pika 1.7, 71 dhe 69 par.4 të LPP –së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se Marrëveshja mbi pengun e datës 25.07.2017 është dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimi dhe është origjinal, prandaj plotëson kushtet ligjore nga nenin 22, pika 1.7 të LPP-së që përcakton se *“Dokumente përmbartuese janë: 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”*, prandaj urdhri përmbartimor ka mbështetje ligjore.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.1213/23, me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**